



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
QENDRA SPITALORE UNIVERSITARE “NËNË TEREZA”

SHPALLJE KËRKESË PËR DONACION

Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” (QSUNT), është Institucion Shëndetësor Publik Kombëtar në shërbim të shëndetit të popullit, të cilit i siguron shërbim shëndetësor parandalues, diagnostikues dhe kurues sipas ligjeve në fuqi, i cili ka në fokus të aktivitetit të tij mbrojtjen e jetës, shëndetit fizik dhe mendor të pacientit dhe lehtësimin e vuajtjeve të tij, duke i ofruar një shërbim shëndetësor sa më cilësor dhe dinjitoz.

Me anë të kësaj thirrje, QSUNT dëshiron të kërkojë vëmendjen e publikut lidhur me mundësinë për të kontribuar në përmirësimin e shërbimit dhe ofrimin e ndihmës në rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj pacientëve të hospitalizuar në QSUNT.

Në vijim të procedurës për instalimin e pajisjes Angiograf Biplanar, QSUT është në pamundesitë kohe dhe objektive për të realizuar procedurën e mbikqyrjes së punimeve për përshtatjen dhe instalimin e pajisjes Angiograf Biplanar.

Kryerja e punimeve për instalimin e pajisjes Angiograf Biplanar nevojitet sa më parë të jetë e mundur.

Mbikqyrja e punimeve bëhet bazuar në Ligjin Nr.8402, datë 10.09.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Udhëzimin Nr.3 datë 15.02.2001 “Për Mbikqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Ligjin 120/2020 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, në Vendimin nr. 610, datë 22.9.2022 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve”.

Duke shpresuar në kontributin tuaj në mbulimin e kësaj nevoje, mirëpresim të gjithë të interesuarit.

QENDRA SPITALORE UNIVERSITARE “NËNË TEREZA”